

Në bazë të nenit 8 pika 1 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 5 dhe 6 pika 5 e Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin publik, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A, me date 08/03/2023 shpall këtë:

PËRSËRITET KONKURS PUBLIK

Shpallim plotësimin e vendit të lirë të punës për pozitën:

Titulli: Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknikë

Vendpunimi: Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi-Dukagjini" SH.A, Gjakovë (Njësia Operative Xërxe dhe Lugbunar)

Numri i referencës: 219

Vendi: Gjakovë

Kohëzgjatja: Puna provuese 6(gjashtë) muaj, me mundësi vazhdimi, në pajtim me Legjislacionin në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën:

- o Ndhmon në përpilimin e planeve afatgjata dhe vjetore të operimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemit të ujitjes dhe kullimit
- o Ndhmon në përpilimin e projekteve, raporteve dhe informatave në lidhje me operimin, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit
- o Reagon dhe ndihmon në zgjidhjen e vështirësive, kërkesave dhe ankesave të qytetarëve (fermerëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve) duke punuar në bashkëpunim dhe në lidhshmëri me Njësitë Punuese në kuadër të Kompanisë
- o Kujdeset dhe mban evidencën për dinamikën e lagështisë së tokës
- o Ndhmon në të gjitha Njësitë Punuese të Kompanisë kur paraqitet nevoja me punëtorë dhe në mënyrë profesionale
- o Ndhmon në mbajtjen e evidencës së harxhimit të sasisë së përgjithshme të ujit si dhe për çdo nënsistem në kuadër të Njesisë Punuese në të cilën punon dhe ndihmon edhe Njësitë tjera Punuese
- o Bën paraqitjen e dëmeve për objektet e sistemit dhe përcjell të gjitha avaritë që ndodhin në sistemin e ujit ku shtrihet Kompania
- o Së bashku me Udhëheqësin e Njesisë bën vërtetimin e sipërfaqeve që ujiten për çdo muaj gjatë sezonës dhe për këtë kërkon nga Tekniku i Bujqësisë shënime për shfrytëzimin e ujit

Kualifikimi:

- Për pozitën e lartëcekur duhet të ketë të përfunduar Fakultetin e Ndërtimtarisë-drejtimi Hidroteknikë.

KUSHTET:

- Preferohet të ketë përvojë në punë dhe në detyra të ngjajshme
- Të jetë në gjendje që t'i kryejë detyrat e punës me përgjegjshmëri
- Te jetë në gjendje të punojë nën presion edhe jashtë orarit të rregullt të punës
- Të ketë aftësi komunikimi, raportimi dhe përshtatshmëri në punë ekipore
- Të ketë njohuri në programe kompjuterike (Microsoft Excel, Ëord etj.)
- Të ketë njohuri në programet Cad (Autocad, Archicad etj.)
- Preferohet njohja e gjuhës angleze dhe programit GIS

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- CV e detajuar
- Letër motivuese
- Diploma përkatëse e noterizuar
- Çertifikatat e trajnimeve
- Dëshmi mbi përvojën në punë (nëse ka)
- Çertifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.
- Dëshmi të mos të jenë të dënuar dhe nën hetime

PROCEDURA E APLIKIMIT:

Aplikacioni–Kërkesa mund të shkarkohet në Web faqen e Kompanisë <https://kruradoniqi-dukagjini.com> dhe i bashkangjiten dokumentacioni tjetër i nevojshëm.

Sqarim:

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zarf të mbyllur (A4) në adresën: Objekti Administrativ i KRU “Radoniqi-Dukagjini” Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së p.n.

- Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike
- Afati i fundit për aplikim është data 23/03/2023 deri në ora 16.00

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe pas afatit të konkurimit do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe të cilët do të jenë të përfshirë në listën e ngushtë.